



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 5/22 Prot.

Elbasan, më 12. 9. 2026

Lënda: Njoftim për afishimin publik në faqen Web dhe këndin e njoftimeve publike.

- SEKTORIT I IT, BASHKIA ELBASAN
- NJËSIA ADMINISTRATIVE GJINAR

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr. 20/2025 "Për paketën e maleve",
- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,
- VKM nr. 625 datë 28.10.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Elbasan",
- Udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkive",
- Urdhëri nr 1003 datë 19.11.2025 Për ngritjen e grupeve të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkues, për tu njohur si "posedues Jopronar"
- Kërkesës së paraqitur nga portali e-albania nga z. Genti Karaj.

Kërkojmë të bëhet afishimi publik me afat 45 (dyzet e pesë) ditor, bazuar në Ligjin Nr. 20/2025 "Për paketën e maleve", neni 10 pika 1 e cila ndër të tjera thotë ... për pasuritë apo pjesët e tyre që përmbushin kushtet, bashkia kryen njoftimin me afishim publik për 45 (dyzet e pesë) ditë në ambientet e saj, në një vend tjetër publik brenda territorit të zonës, si dhe në faqen zyrtare të saj të internetit. Afishimi përmban listën e subjekteve me sipërfaqet respektive, përshkrimin e vendndodhjes së tyre dhe shoqërohet nga plani i rilevimit përkatës. Për sa më sipër kërkojmë që të merrni masat të bëhet afishimi pranë këndit të njoftimeve të njesisë Administrative Gjinar, në faqen e internetit të Bashkisë Elbasan si dhe në këndin e njoftimeve të Bashkisë Elbasan.

Planvendosja e pretenduesit të z.Genti Karaj ndodhet në njësinë administrative Gjinar, në zk 1742 pasuria. A+B sipas planvendosjes me një sipërfaqe prej 2,125 m². (Bashkangjitur plan vendosja) Me përfundimin e afatit 45 ditor, duhet të përcillet procesverbali i mbajtur nga personi përgjegjës për afishimin, ku citohet përfundimi i afatit të afishimit, si dhe, nëse ka pasur ankesa apo jo lidhur me pasurinë në objekt trajtimi, në mënyrë që të vijojë me procedurën.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

KRYETARI


Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE MË URDHËR

ZV/KRYETARI

Asim Sula





EMERTIMI	PLANVENDOSJA E RELIEVIT
VENDNDODHJA	ELBASAN-GJINAR
POROSITI	GENTI KARAJ

DATA E PERGATITJES	ELBASAN ME 10/07/2026	FIRMA
PERGATITI	Ing. LUAN MEMA Licença Nr. T1056/1 Dt.12.06.2018	
	T2	